




REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. 03-02/DPK	Nr Prot. 01-1407/16
Dep. 03-02/DPK	Bi Prot. 01-1407/16
Nr. I fau	Prot No. 01-1407/16
Broj stranica 02	Data 07-04-2016
Nr. pages	Datum 07-04-2016
PRISHTINE	



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosova**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE**  
**ANTI - CORRUPTION AGENCY**

Duke u bazuar në nenin 11 (paragrafi 1.1), nenin 5 (paragrafi 1.5) dhe nenin 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 24 (paragrafi 11 dhe 12) të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 06.04.2016, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

**I. Mbyllet rasti me nr. AKK – 03-02-748/16, për z. Januz Kabashi – Kryeshef Ekzekutiv në Ndërmarrjen Hidroekonomike “Ibër - Lepenc”, për shkak se nuk ka të dhëna të mjaftueshme që argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit.**

**II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.**

**A r s y e t i m**

**I. Rasti i hapur pas një informacioni të deponuar në Agjencinë kundër Korrupsionit, nën dyshimin për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, nr. AKK – 03-02-748/16, për z. Januz Kabashi – Kryeshef Ekzekutiv në Ndërmarrjen Hidroekonomike “Ibër -Lepenc”, është mbyllur për shkak se nuk qëndrojnë pretendimet e palës denoncuese .**

Dyshimet për konflikt interesi kanë qenë sepse, sipas denoncuesit të rastit, në procesin e përzgjedhjes së Kryeshefit Ekzekutiv në Ndërmarrjen “Ibër - Lepenc”, nuk janë respektuar kriteret e konkursit për këtë pozitë. Konkretisht, nuk janë respektuar dispozitat e nenit 21.4 të Ligjit (nr. 03/L-087) për Ndërmarrje publike, i cili ndër të tjera përcakton:

*21.4 Për përzgjedhjen së personave për emërim si zyrtarë të NP-së, Bordi i Drejtorëve duhet të kryejë një procedurë të hapur, transparente dhe konkurruese e cila ka për qëllim që të gjitha emërimet të bëhet ekskluzivisht në bazë të meritës. Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë që të gjithë personat e emëruar si zyrtarë të jenë person me integritet të njohur të cilët (i) i plotësojnë kushtet e kualifikimit sipas Nenit 17.1, (ii) i plotësojnë kriteret e pavarësisë sipas nenit 17.2, pikat (d), (f), (j), (k) dhe (l) dhe (iii) kanë përvojën e nevojshme profesionale dhe shkollimin e kërkuar për pozitën në fjalë.*

Po ashtu, sipas denoncuesit të këtij rasti, nuk janë respektuar dispozitat e nenit 17 i cili përcakton kushtet e kualifikimit dhe përshtatshmërisë profesionale dhe pavarësinë e personave që aplikojnë për drejtor të Ndërmarrjeve Publike. Paragrafi 2 i këtij neni, pika k), përcakton se:

*“Të gjithë drejtorët përveç KE duhet të jenë të pavarur. Një person nuk konsiderohet i pavarur dhe nuk kualifikohet për zgjedhje si drejtor në një NP nëse: k) është ose në çfarëdo kohe gjatë periudhës 36 muajsh para datës së aplikimit ka qenë (i) zyrtar i zgjedhur publik, (ii) i emëruar politik ose (iii) bartës i një posti udhëheqës ose vendimmarrës në një parti politike”.*

Zyrtari i zgjedhur publik nënkupton individin i cili ushtron një post publik, të cilin e ka fituar përmes zgjedhjeve ndërsa i emëruari politik nënkupton personin i cili është emëruar, ose propozuar nga subjekti politik si kandidat për një post të zgjedhur (neni 2 i Ligjit nr 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike).

Pas pranimit të këtyre informacioneve, zyrtari i lartë është njoftuar me shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, pas së cilës zyrtarët e Agjencisë kanë organizuar takim.

Zyrtari i lartë, z. Januzi në takim ka deklaruar se të gjitha këto dispozita vlejnë për Anëtarët e Bordeve por jo edhe për Kryeshefat Ekzekutiv të Ndërmarrjeve Publike. Neni 17.2 përcakton se të gjithë drejtorët përveç Kryeshefit Ekzekutiv duhet të jenë të pavarur.

z. Januzi po ashtu është njoftuar se nuk mund të ushtroj funksionin e Drejtorit në Komunën e Istogut, krahas funksionit publik të Kryeshefit Ekzekutiv në Ndërmarrjen “Ibër - Lepenc”. Ai ka deklaruar se në momentin që është zgjedhur Kryeshef Ekzekutiv ka dhënë dorëheqje nga funksioni i Drejtorit në Komunën e Istogut.

Për këtë ka sjellur në Agjenci shkresën zyrtare, të lëshuar nga Kryetari i Komunës së Istogut, me të cilën vërtetohet se z. Januzi nuk e ushtron më këtë funksion.

Andaj, duke marrë parasysh të gjitha faktet dhe rrethanat relevante që i posedojmë në lidhje me çështjen e konfliktit të interesit për këtë rast, si dhe dispozitat e lartcituara, vlerësojmë se nuk ka të dhëna të mjaftueshme që argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit apo papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit publik.

Andaj u vendos si në dispozitivin e këtij vendimi.

II. Në pajtim me nenin 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik;
- Drejtorit të DPK- së;
- Z./zgj. (zyrtarit përgjegjës).

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

Hasan Preteni

